

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Ministrinë e Drejtësisë në kuadër të inspektimeve tematike dhe përmbushjes së detyrave të tjera funksionale;

Vlerëson veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2023 në këto drejtime:

Trajtimin dhe përfundimin të plotë të shqyrtimit të 2104 ankesave të trashëguara nga organet kompetente gjatë periudhës kalimtare (*backlog*) në mënyrë të paanshme dhe duke ndjekur parimin e proporcionalitetit, ku vetëm për vitin 2023 janë shqyrtuar më shumë se 50% e këtyre ankesave.

Miratimit të 18 vendimeve për hetim disiplinor në të cilat janë hetuar shkeljet e pretenduara për 25 magjistratë, nga të cilët 4 prokurorë dhe 21 gjyqtarë, kryesisht për shkelje të pretenduara në lidhje me vonesa të përsëritura dhe zvarritje të pajustificuara të akteve procedurale, si dhe veprime ose mosveprime që sjellin përfitime të padrejta ose dëme për palët në proces gjyqësor.

Përfundimit të dy inspektimeve tematike për të cilat janë lënë rekomandime të karakterit legjislativ, organizativ dhe mirëfunksionimit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen si të ndërgjegjësisë, ashtu dhe të eficiencës së veprimtarisë së organit të inspektuar.

Fillimit të procesit për vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve dhe përfundimin e vlerësimit për njërin prej tyre, duke hapur rrugë ngritjes së komisioneve përkatëse për vlerësimin e inspektorëve, emërimin e inspektorëve jomagjistratë dhe zgjedhjen e zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rritjes së bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira të punës, ku mund të veçohet anëtarësimi me të drejta të plota në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë dhe angazhimi në projektin e nisur nga Komisioni Evropian “Bashkëpunimi për mbrojtjen e mjedisit nga Autoritetet Kombëtare të Inspektimit të Drejtësisë”.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2024 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të adresojë nëpërmjet instrumenteve që i jep ligji problematikat e ndjeshme për publikun, si institucion garantes i sistemit të drejtësisë, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të besimit të publikut jo vetëm për ILD-në, por për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.

2. T’i kushtohet vëmendje e veçantë plotësimit të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat.

3. Të ndërmarrë masa të rregullta për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standardet e larta të procesit të rivlerësimit, veçanërisht për inspektorët jomagjistratë.

4. Të rritet numri i inspektimeve institucionale me objektiv të qartë dhe të përcaktuar, të fokusuar në aspektet specifike të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorisë për menaxhimin e çështjeve dhe administrimin gjyqësor dhe hetimor.

5. Të përfundojë vlerësimin etiko-profesional të inspektorëve në një kohë të arsyeshme dhe rezultatet e vlerësimit të përdoren për të zhvilluar programe trajnimi në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale.

6. Të angazhohet për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit në hetime dhe inspektime tematike, si dhe koordinimin e veprimeve për të adresuar çështje të përbashkëta.

7. Të përmirësojë treguesit e transparencës dhe aksesueshmërinë e publikut, duke publikuar informacione periodike, raporte dhe çdo të dhënë tjetër që reflekton veprimtarinë institucionale.

8. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.7.2024.